

VENDIM
Nr.338, datë 6.6.2007

**PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE, TOKA
PYJORE PUBLIKE, KU JANË NDËRTUAR STACIONE BAZË TË TRANSMETIMEVE TË
SINJALEVE (BTS), NGA MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË
UJËRAVE TE MINISTRIA E BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 14, 15, shkronja “c”, e 16, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Të gjitha tokat pyjore publike, ku janë ndërtuar, instaluar apo përshtatur stacione bazë të transmetimeve të sinjaleve (BTS), i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme.

2. Ndryshimi i përgjegjësisë së administrimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve dhe Kullotave, në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të Ministrisë së Brendshme, sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për territorin funksional, ku është vendosur stacioni bazë, si dhe për mjediset e tjera ndihmëse të stacionit.

3. Marrëdhëniet e Ministrisë së Brendshme me personat e tretë, publikë apo privatë, që kanë ndërtuar ose kanë marrë me qira stacione, në tokat e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi, të rregullohen sipas dispozitave të Kodit Civil.

4. Ngarkohen Ministri i Brendshme, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, që, brenda 20 ditësh, të përcaktojnë sipërfaqet e sakta, për efekt të pikës 2 të këtij vendimi.

5. Lista e tokave pyjore publike, sipas pikave 1 e 2 të këtij vendimi, i dërgohet për zbatim kryeregjistruesit të Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë.

6. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA